



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E ARTEVE

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë.



Universiteti i Prishtinës
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINENSIS
FAKULTETI I ARTEVE
Nëna Tereza, 10000 Prishtinë, Kosovë

Prishtine me *11.03.2010*

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

Ndërmjet

AKADEMISE së ARTEVE të TIRANES

Dhe

UNIVERSITETIT të PRISHTINES - FAKULTETIT TE ARTEVE

Universiteti Shtetëror i Prishtines, përfaqësuar nga **Prof.Mujë RUGOVA** në cilësinë e Rektorit

Dhe

Akademia e Arteve, Tiranë, përfaqësuar nga **Prof. Petrit MALAJ**, në cilësinë e Rektorit.

Duke konsideruar se Fakulteti i Arteve të Prishtinës dhe Akademia e Arteve në Tiranë janë Institucione të formimit të lartë profesional metodiko-artistik, të njohura në plan kombëtar dhe ndërkombëtar;

Duke konsideruar se dy Institucionet e lartpërmenduar kanë bindjen se aktivitete dhe bashkëpunime të ndërsjella sjellin vetëm dobi dhe ndikime të favorshme mbi cilësinë e forcave të tyre akademike

Duke konsideruar se nënshkruesit e këtij dokumenti janë të bindur se puna dhe bashkëpunimi do të sjellin krijimin e modeleve të bashkëpunimit ndër-institucional e të asistences teknike në nivel ndërkombëtar;

Të dy palët pajtohen që:

1. Nënshkruarit të promovojnë bashkëpunimin dhe kooperimin duke inkurajuar lëvizjen e studentëve
2. Zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta të tilla si seminare, takime, kongrese, punë kërkimore shkencore në grup, publikime, botime
3. Shkëmbimin e informacioneve dhe dokumentave, publikimeve, katalogëve, kurrikulave të cilat ndihmojnë punën hulumtuese
4. Pranimi ose njohja e diplomës së studentëve fituar nga universiteti i tyre për t'u regjistruar në universitetin pritës.
5. Shkëmbime reciproke të pedagogëve dhe studiuesve shkencorë.
6. Shfrytëzimi i burimeve dhe forcave të nevojshme për aktivitetet e përmendura të bashkëpunimit të jetë nën kujdesin e nënshkruarëve.

Miratuar

Për
Universitetin e Prishtinës
Fakultetin e Arteve



Prof. Mujë RUGOVA Rektor

Për
Akademinë e Arteve në Tiranë



Prof. Petrit MALAJ Rektor

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
REKTORATI
PRISHTINË

Pranuar me dt.	11	03	10
Njësia org.	Numar	Titulli/Emri	Vlera
01	748		